



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2018, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Fatmir Fejzullahu dhe Kadri Berisha.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 2593-0, e evidentuar në certifikatën e pronës P-71914059-02593-0, Zona Kadastrale (ZK) Prishtinë, e evidentuar si "pasuri shoqërore", Kuvendi Komunal Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale 10073-10, ZK Prishtinë, e evidentuar në certifikatën e pronës nr. P-71914059-010073-10, në emër të pronarëve Fatmir Fejzullahu dhe Kadri Berisha, me destinim "rrugë", e planifikuar sipas Planit rregullues "Muhaxhirët".
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e planit rregullues urban, kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës, dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelave kadastrale që do të këmben.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmben, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.

- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0263778/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

